



**IBN REXHEB EL-HANBELI**  
**Përshëndetja**  
**lamtumirëse e**  
**RAMAZANIT!**



  
Literatura  
**ISLAME**

Ibn Rexheb el-Hanbeli

**PËRSHËNDETJA  
LAMTUMIRËSE E  
RAMAZANIT!**



Ibn Rexheb el-Hanbeli

**Përshëndetja      lamtumirëse      e  
Ramazanit!**

*Shkëputur nga libri "Lataif el-Mearif"*

Përktheu në gjuhën shqipe: Hekuran Helshani

Boton: [literaturaislame.com](http://literaturaislame.com)



**T**ransmetohet në Sahihajn<sup>1</sup> se Ebu Hurejra përcjell nga Pejgamberi ﷺ se ka thënë: *"Atij që falet Natën e Kadrit, duke besuar dhe llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës. Atij që agjëron Ramazanin duke besuar dhe llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës."* Po ashtu, në Sahihajn, në një hadith tjetër të transmetuar nga Ebu Hurejra, Profeti ﷺ ka thënë: *"Atij që e fal namazin e natës gjatë Ramazanit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës."* Kurse Nesai<sup>2</sup> në një motërzim tjetër transmeton: *"Atij që agjëron Ramazanin duke besuar dhe llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës dhe të së ardhmes."*

Gjithashtu, një hadith i ngjashëm në lidhje me namazin e Natës së Kadrit është transmetuar edhe nga Ubade ibn Samiti (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

---

<sup>1</sup> Dy librat e saktë të hadithit: Sahihu i Buhariut dhe Sahihu i Muslimit. Ky hadith transmetohet në Buhari, 1901, në kapitullin e agjërimit, nënkapitulli "Ai që agjëron Ramazanin me besim dhe me shpresë në shpërblim."

<sup>2</sup> Nesaiu: 155-157 në lidhje me agjërimin, kapitulli mbi shpërblimin për atë që qëndron në namaz me besim dhe duke llogaritur në shpërblim.

Shlyerja e mëkateve është përmendur e kushtëzuar me ruajtjen nga gjërat prej të cilave (besimtari) duhet ruajtur. Është transmetuar në Musnedin<sup>3</sup> e Imam Ahmedit dhe në Sahihun e Ibn Hibanit, nga Ebu Seid Hudriu se Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Atij që agjëron Ramazanin dhe ruan kufijtë e tij, dhe ruhet nga gjërat prej të cilave duhet ruajtur, i falen mëkatet e kaluara."* Pjesa dërmuese e dietarëve janë të mendimit se të këtitillit i falen mëkatet e vogla, gjë për të cilën dëshmon ajo që ka transmetuar Muslimi<sup>4</sup> nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *"Pesë namazet, namazi i xhumasë deri në namazin e xhumasë tjetër dhe Ramazani deri në Ramazanin tjetër janë falje për mëkatet e bëra mes tyre, nëse njeriu ruhet prej mëkateve të mëdha."*

---

<sup>3</sup> Musnedi i Imam Ahmedit, 3/55, Sahihu i Ibn Hibanit, 879; Mevarid, et-Tergib uet-Terhib, 2/91.

<sup>4</sup> Sahihu i Muslimit, 233, në lidhje me Pastërtinë, kapitulli që flet se: pesë namazet, Xhumaja deri në Xhuma dhe Ramazani deri në Ramazan janë shlyerje të mëkateve për periudhën ndërmjet tyre. I pari që e ka transmetuar është Tirmidhiu në Sunenin e tij, 214, në lidhje me namazin, kapitulli që flet për vlerën e pesë namazeve.



Për këtë ka dy shpjegime:

I pari: Shlyerja e mëkateve të vogla varet nga heqja dorë nga mëkatet e mëdha, kështu që, atij që nuk e ruan veten nga kryerja e mëkateve të mëdha, nuk do t'i shlyhen as mëkatet e mëdha e as mëkatet e vogla.

I dyti: Qëllimi është që këto vepra të obligueshme (farze) janë shlyerje për mëkatet e vogla në veçanti, në të gjitha situatat, pavarësisht nëse janë shmangur mëkatet e mëdha apo jo; edhe pse mëkatet e mëdha nuk do të shlyhen.

Lidhur me qëndrimin në namaz në Natën e Kadrit, Ibn Mundhiri (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Shpresohet për faljen e të gjitha mëkateve, të mëdhave dhe të voglave." Dijetarë të tjerë kanë dhënë mendime të ngjashme në lidhje me agjërimin. Megjithatë, konsensusi i përgjithshëm i dijetarëve është se për faljen e mëkateve të mëdha është kërkohet pendimi i singërtë. Këtë çështje e kemi diskutuar gjatë në vende të tjera.



Pra, hadithi i Ebu Hurejres (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se këto tri shkaqe, secila prej tyre është shlyese e mëkateve të bëra më herët, e ato janë:

1. Agjërimi i Ramazanit,
2. Qëndrimi në namaz nate dhe
3. Qëndrimi në namaz nate gjatë Natës së Kadrit.

Qëndrimi (në adhurim) në Natën e Kadrit është në vetvete një shlyerje e mëkateve, siç përmendet në hadithin Ubade ibn Samitit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), të cilin e diskutuam në fillim të këtij seksioni. Pavarësisht nëse Nata e Kadrit është në fillim, në mes apo në fund të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit, ose nëse një person e ndjen praninë e saj apo jo, shlyerja e atyre gjynaheve nuk do të vonohet deri në fund të muajit.

Si për agjërimin, ashtu edhe për qëndrimin në këmbë për adhurim gjatë Ramazanit, shlyerja e mëkateve fitohet në fund të muajit. Pra, mëkatet e tij të mëparshme do t'i falen pas përfundimit të agjërimit dhe qëndrimit (në adhurim) gjatë gjithë Ramazanit. Është thënë gjithashtu se atij do ti falen mëkatet pas përfundimit të namazit në natën e fundit të Ramazanit, para mbarimit të agimit. Kurse falja që





pason nga agjërimi do të vonohet deri në përfundimin e mëngjesit me agjërim. Pra, ai do të jetë i falur si rezultat i agjërimit që ka bërë, në prag të Bajramit të Fitrit. Këtë e dëshmon Imam Ahmedi<sup>5</sup> në hadithin nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ku Pejgamberi ﷺ ka thënë:

*“Umetit tim i janë dhënë pesë cilësi në Ramazan që nuk i janë dhënë ndonjë populli tjetër pos tyre:*

- 1. Era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa aroma e miskut,*
- 2. Engjëjt kërkojnë falje për ta derisa të prishin agjërimin,*
- 3. Allahu e zbukuron Xhenetin e Tij çdo ditë dhe thotë: “Robërit e Mi janë në prag të heqjes së plotë të barrëve dhe papastërtive të tyre dhe po vijnë drejt Teje;”*
- 4. Shejtanët rebelë lidhen me zinxhirë, saqë ata nuk mund t'i qasen asaj që mund t'i qaseshin normalisht në muajt e tjerë, dhe*
- 5. Atyre u falen mëkatet natën e fundit të Ramazanit.*

---

<sup>5</sup> Musnedi i Imam Ahmedit 2/292, dhe është përmendur nga Hejthemiu në Mexhma' Ez-Zavaid 3/140, ku ka thënë: “Tregohet nga Ahmedi dhe Bezari, dhe në të është Hisham ibn Zijad Ebu El-Mikdami, ndaj është i dobët.” Për më shumë, shih Metalib el-Alijeh (932) dhe Mushkil El-Ethar 4/142.

Dikush pyeti: "O i Dërguar i Zotit, a është për qëllim nata e Kadrit?" Tha: *"Jo, porse punëtorit i jepet pagesa pasi ta mbarojë punën."*

Po ashtu është transmetuar se ata që kanë agjëruar do të kthehen në ditën e Bajramit, të falur (nga mëkatet), dhe se dita e Bajramit quhet Dita e Shpërblimit sipas disa haditheve të dobëta. Imam Zuhriu ka thënë: "Ditën e Bajramit, njerëzit dalin në namazgja (vendfalje)<sup>6</sup>, Zoti i shikon dhe u thotë: "O robërit e mi, agjëruat për Mua dhe u falët për Mua, kthehuni të falur."

Muverrik El-Ixhli u tha disa prej shokëve të tij që ishin ulur me të në vendin e faljes (namazgja) Ditën e Bajramit: "Këtë ditë një pjesë e njerëzve do të kthehen ashtu siç i kanë lindur nënat e tyre (pa mëkate)." Dhe në një hadith mursel nga Ebu Xhafer El-Bakiri thuhet: "Kush e arrin Ramazanin dhe i agjëron ditët e tij, si dhe falet një periudhë të caktuar gjatë netëve të tij, ul shikimin, ruan pjesët intime, gjuhën dhe dorën e tij nga mëkati, e fal namazin me xhemat dhe arrin herët për namazin e xhumasë; i këtilli e ka agjëruar muajin dhe është shpërblyer, e

---

<sup>6</sup> Këtu është përdorur shprehja "Xheban" për vendfaljen, e që është për qëllim falja në vend të hapur në shkretëtirë, siç e bënin atëbotë muslimanët.



ka zënë Natën e Kadrit dhe ka fituar shpërblimin nga Zoti". Ebu Xhaferi komenton: "Ky shpërblim nuk i ngjan atij që jepet nga mbretërit e kësaj bote."

Kur agjëruesit të kenë plotësuar agjërimin e Ramazanit dhe faljen e namazit gjatë netëve të tij, ata tashmë kanë mbaruar atë që ka qenë e kërkuar prej tyre prej punëve të mira, ndaj ka mbetur shpërblimi që u takon, e që është falja e mëkateve. Kur të dalin për namaz në ditën e Bajramit, do t'u shpërndahen shpërblimet e tyre, ndaj do të kthehen në shtëpitë e tyre me shpërblimin e tyre të plotë, siç e gjejmë në hadithin e Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të!): "Në ditën e Bajramit të Fitrit, engjëjt zbresin në tokë dhe qëndrojnë në krye të çdo rrugice duke thirrur me një zë që mund të dëgjohet nga të gjithë krijesat e Zotit – përveç njerëzve dhe xhinëve – duke thënë: "O Umeti i Muhamedit! Dilni para Një Zoti Bujar që jep shumë dhe falë mëkate të mëdha!" E kur të dalin në vendfalje, Zoti i Lavdishëm e i Madhërishëm u thotë engjëjve të Tij: "O melekët e Mi! Cili është shpërblimi për punëtorin pasi ta ketë kryer punën?" Ata do të përgjigjen: "Zoti ynë dhe Pronari ynë! Që t'u jepni atyre shpërblimin e plotë." Atëherë, Ai thotë: "Me të vërtetë, jini dëshmitarë se për agjërimin dhe qëndrimin e tyre në namaz, Unë i kam shpërblyer ata me kënaqësinë Time dhe faljen Time."



Shpërndahuni, të gjithë jeni të falur.” Kjo është transmetuar nga Seleme ibn Shebibi në librin “Virtytet e Ramazanit” dhe në të tjera. E, sa i përket zinxhirit të transmetimit të këtij hadithi, ka mospajtime. Por është transmetuar edhe përmes një rruge tjetër nga Ikrimë, e ky nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) si fjalë e tij (mevkuf).

Në fakt, kuptimi i kësaj thënie është transmetuar edhe drejtpërdrejt nga Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), përmes rrugëve të tjera që nuk shpëtojnë nga dobësia: *“Kush e kryen punën e cila i është caktuar të plotë, edhe shpërblimin e ka të plotë, dhe kushdo që dorëzon të plotë atë që kërkohet prej tij, duhet të shpërblehet me para në dorë, pa vonesë.”*

(Siç thuhet në poezi)

*Nuk do ta shes zemrën time,  
nëse nuk lidhesh thellë me mua,  
As nuk do ta dorëzoj zemrën time tek ti,  
nëse nuk mund ta bëj këtë dorë më dorë;*

\* \* \*

*Dhe nëse e përmbushni atë që më keni premtuar,  
edhe unë do ta përmbush pjesën time;  
Por nëse refuzoni,  
atëherë hipoteka do të mbetet pronë e imja.*

Kushdo që dështon ose ka mangësi në kryerjen e veprave të mira, do t'i pakësohet shpërblimi në përputhje me mangësitë e tij. I këtilli nuk do të mund ta fajësojë askënd pos vetes së tij. Selman Farisiu ka thënë: "Namazi është peshore, ai që jep, i jepet (shpërblimi për të), kurse ai që është i pakujdesshëm (taffefe) ... atëherë ju e dini se çfarë është thënë në lidhje me mutafifin<sup>7</sup>." Agjërimi dhe

---

<sup>7</sup> Shih ajetet e sures Mutafifin: "Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), që, kur masin për veten, e marrin masën të



të gjitha veprat e tjera të mira gjithashtu shpërblehen në këtë mënyrë, kushdo që i kryen veprat e tij siç duhet do të llogaritet në mesin e robërve të zgjedhur të Allahut, të cilëve u jepet shpërblimi. Por mjerë mutaffinët (ata që hanë në peshë dhe matje), ata që përpiqen të mashtrojnë Zotin në kryerjen e veprave. A nuk turpërohet ai që e mbush peshoren e tij me ndjekjen e pasioneve të tij, kurse është i mangët në mbushjen e peshores me agjërime dhe namaz – “Qoftë larguar (nga mëshira e Zotit) populli i Medjenit!”<sup>8</sup> Në hadith është thënë: *“Më të këqijtë nga njerëzit janë hajdutët, gjegjësisht ata që vjedhin nga namazi i tyre.”*<sup>9</sup> Andaj, nëse mallkimi bie mbi atë që lë mangu peshoren e kësaj bote, vallë si është puna me atë që lë mangu peshoren e fesë (dinit): “Mjerë për ata të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet e tyre!” (Maun, 4, 5)

---

plotë, ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë.” (1-3)

<sup>8</sup> Populli i Medjenit ishin populli i pejgamberit Shuajb, të cilët u shkatërruan për shkak se mashtronin në peshore.

<sup>9</sup> Imam Ahmedi e ka transmetuar në Musnedin e tij nga Ebu Katade, se Profeti ﷺ ka thënë: *“Më të këqijtë nga njerëzit janë hajdutët, gjegjësisht ata që vjedhin nga namazi i tyre.”* Atëherë njerëzit pyetën: “O i Dërguari i Allahut, si mund të vjedhë dikush nga namazi i tij?” Ai u përgjigj: *“Duke mos plotësuar rukunë dhe sexhden.”*



*Nesër, të gjithëve do t'u jepet ajo ç'kanë fituar;*

*Bujqit do të mbledhin të korrurat e tyre.*

\*\*\*

*Nëse kanë bërë mirë, i kanë bërë mirë shpirtit të tyre.*

*E nëse kanë bërë të këqija, atëherë sa e mjerë është ajo që kanë punuar.*

Paraardhësit e devotshëm (selefët) gjithmonë përpiqeshin t'i përsosnin, plotësonin dhe filtronin veprat e tyre në çdo mënyrë, kurse pas përfundimit të tyre, ata preokupoheshin për pranimin e atyre veprave para Zotit, nga frika se mund t'u refuzohen. Ata ishin që: “kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre.” (Muminun, 60)

Transmetohet se Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Kujdesuni për pranimin e veprave tuaja më shumë sesa për kryerjen e tyre; a nuk e keni dëgjuar Allahun Fuqiplotë të thotë: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmëve.” (Maide, 27) Po



ashtu, transmetohet nga Fadale ibn Ubejdi<sup>10</sup> se ka thënë: "Ta dijë se Allahu ma ka pranuar një vepër qoftë edhe sa një farë sinapi, do të ishte më e dashur për mua se dynjaja dhe çfarë ka në të, ngase Allahu ka thënë: "Allahu pranon vetëm prej të devotshmëve." (Maide, 27) Kurse Ibn Dinari<sup>11</sup> ka thënë: "Frika se nuk do të të pranohet vepra duhet të jetë më e madhe sesa kryerja e saj." Kurse Ataë es-Sulemiu<sup>12</sup> ka thënë: "Ajo që duhet t'i kushtojmë

---

<sup>10</sup> Emri i plotë i Fadales ishte Fadale ibn Ubejd ibn Nafidh ibn Kajs, Ebu Muhamed el-Ensariu el-Evsiu, njëri nga sahabët e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai ishte në mesin e të pranishmëve në Besën e përgjithshme nën Pemë (Bejeatu Ridvan), e përmendur në Kuran (48:18). Ai gjithashtu shërbeu si komandant luftime gjatë sundimit të Muavijes si halif, si dhe gjykatës në Damask. Vdiq në vitin 58 Hixhri. Për më shumë, shih "Sijeru Alami en-Nubela", 3/113-117, të Dhehebiut.

<sup>11</sup> Emri i plotë i Ibn Dinarit ishte Malik ibn Dinari, por njihej edhe si Ebu Jahja. Ai ishte një asket, i përkushtuar ndaj së vërtetës, në mesin e pasardhësve të famshëm të të parëve tanë të devotshëm (selefëve) dhe ishte një mjeshtër në shkrimin e Kuranit. Vdiq në vitin 130 h. Për më shumë, shih "Sijeru Alami en-Nubela", 5/362, të Dhehebiut.

<sup>12</sup> Emri i tij i plotë ishte Ebu Abdullah ibn Ebu Ubejde el-Basri el-Sulemi. Ai ishte ndër pasardhësit më të vegjël të selefëve, por ishte mjaft i vjetër sa të kishte takuar Enes ibn Malikun, një nga sahabët e shquar të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai gjithashtu ishte i pranishëm për të dëgjuar disa nga ligjëratat e Hasan el-Basriut. Ishte një asket dhe ishte i dalluar me



vëmendje është frika se a jemi duke i bërë veprat vetëm për Allahun.” Abdulaziz ibn Ebu Revadi<sup>13</sup> ka thënë: “I kam arritur (selefët) të përkushtuar shumë për të kryer vepra të mira, por pas mbarimit të veprës i kaplonte brenga se a do t’u pranohet apo jo.”

Po ashtu, disa nga selefët kanë thënë: “Ata e lusnin Allahun për gjashtë muaj që t’ua mundësonte arritjen e muajit të Ramazanit, pastaj gjashtë muaj të tjerë e lusnin Allahun t’ua pranonte veprat.”

Omer ibn Abdulazizi (Allahu e mëshiroftë!) doli njëherë në hutbe ditën e Bajramit të Fitrit dhe tha: “O njerëz! Ju i agjëruat tridhjetë ditë për Allahun, falët namaz nate tridhjetë netë, kurse sot keni dalë këtu për t’i kërkuar Allahut që t’jua pranojë veprat tuaja.” Madje, kishte prej selefëve që ditën e Bajramit të Fitrit dukej qartë mërzia tek ta, e kur dikush u thoshte: “Sot është ditë gëzimi dhe lumturie,”

---

adhurime, si dhe ishte i njohur për këshillimin e të tjerëve që t’i frikësohen Zotit dhe t’i mposhtin hilet e egos (nefsit). Thuhet se ai vdiq pas vitit 140 h. Për më shumë, shih “Sijeru Alami en-Nubela”, 6/86, të Dhehebiut; Sifat es-Safva 3/325.

<sup>13</sup> Ai ishte shejhu i Mesxhidul-Haramit (Qabes) dhe prej atyre imamëve të mëdhenj të njohur si adhures të devotshëm. Gjithmonë i sinqertë, ai ishte armik i atyre që besonin në idenë e irxhasë (mos konsiderimit të veprave si pjesë përbërëse e besimit). Vdiq në vitin 159 h.

thoshin: "Është e vërtetë, po ja që unë jam thjesht një rob që Zoti i tij e ka urdhëruar të kryejë një vepër për të, kurse unë nuk e di se a do të ma pranojë apo jo!"

Vuhejbi bin Verdi<sup>14</sup> njëherë pa disa njerëz duke qeshur në ditën e Bajramit, ndaj tha: "Nëse këtyre u është pranuar agjërimi, kështu nuk veprojnë ata që janë falënderues, e nëse nuk u është pranuar agjërimi, kështu nuk veprojnë ata që kanë frikë." Transmetohet nga Haseni se ka thënë: "Allahu e ka bërë muajin e Ramazanit arenë për robërit e Tij, që të garojnë me adhurime për të fituar kënaqësinë e Tij, kështu, një pjesë e njerëzve garuan dhe fituan, sakaq të tjerë mbetën mbrapa dhe u shkatërruan. Ndaj, është për t'u çuditur me lojtarët që qeshen në ditën kur të mirët fitojnë kurse ata që ndoqën të kotën humbën."

---

<sup>14</sup> Ai është Vuhejb ibn Verd el-Kurashij, Ebu Othman el-Mekij ez-Zahid. Atë e kanë konsideruar të besueshëm Ibn Maini dhe Nesaiu. Prej tij kanë transmetuar Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu. Ibn Hibani thotë se ka vdekur në vitin 153 h.


*Ndoshta Ti je i Hidhëruar  
tekta zemra ime është e shkujdesur ...  
Paqja qoftë mbi dynjanë dhe Ahiretin,  
nëse me mua je i Kënaqur!*

Transmetohet se Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në natën e fundit të Ramazanit thërriste: “Ah çfarë më gjeti! Vallë kush është i pranuari e ta urojmë, e kush është i privuari e ta ngushëllojmë!?” Ndërsa Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: “Vallë, cili prej nesh është i pranuari që ta urojmë, e cili prej nesh është i privuari që ta ngushëllojmë!? O ti i pranuari, lum për ty, dhe o ti i refuzuari, Allahu ta lehtësoftë këtë fatkeqësi!”

*A thua vallë, cili prej nesh do të jetë i pranuar e të  
përgëzohet...*

*Vaj halli për të refuzuarin!  
E kush shpinën ia kthen, i papranuar...  
Allahu e poshtëroftë si është më së keqi!*





Çfarë ka humbur ai që ka humbur mirësinë e Ramazanit? Dhe çfarë ka bërë për vete ai që është privuar nga e mira e saj? Sa dallim të madh ka mes atyre që shpërblim kanë pranim dhe falje, dhe mes atyre që shpërblimi i tyre do të jetë zhgënjimi dhe humbja e plotë? Ndoshta është ai që qëndron në namaz gjatë gjithë natës, por nuk do të përfitojë asgjë tjetër përveç pagjumësisë, ose ai që agjëron gjithë ditën, por nuk do të përfitojë asgjë prej tij përveç urisë dhe etjes.

*Çfarë të bëj?*

*Kështu është puna e caktimit hyjnor...*

*Ngushëllimi shkon për të tjerët,  
ndërsa unë mbetem i thyer!*

\*\*\*

*Rob i mëkatit, i lidhur e i braktisur...*

*Vallë si mund të ndryshojë ajo që tashmë është e  
caktuar!*

\*\*\*

*Njerëzit ecën*

*ndërsa mua më prangosi fati i keq...*

*Ata arritën afërsinë (me Zotin),  
kurse ashpërsia mua më largoi (nga Ai).*

\*\*\*

*Më mjafton, më mjafton (o Zot),  
deri kur do t'më përzësh?...*

*Armiqtë më janë bërë sëmundje,  
më kanë halë në sy.*

\*\*\*

*Shkaqet e dashurisë për ty,  
m'i shuan shkaqet e mia...*

*që kur më ke lënë anash,  
dhimbja ka qenë pjesa e imja.*

\*\*\*

*Mundësitë e mia më janë shteruar,  
sakaq Ti e di se çfarë kam...*

*Mëshiro, se robi tek dera po të qëndron!*



Në Ramazan, mjetet për të arritur faljen e Zotit shumohen, disa prej tyre janë si në vijim:

- Agjërimi
- Qëndrimi në namaz të natës dhe qëndrimi në natën e Kadrit në adhurim, siç u përmend më lart
- Dhënia e iftarit agjëruesve dhe lehtësimi (i punëve) shërbëtorëve që dikush mund t'i posedojë. Këto dy vepra janë përmendur në mënyrë specifike në një hadith nga Selman Farisiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!).
- Përkujtimi i Allahut (dhikri). Në një hadith nga Pejgamberi ﷺ thuhet: *"Atiji që e përmend Allahun shpesh në Ramazan, i falen mëkatet."*<sup>15</sup>
- Kërkimi i faljes. Istigfari është të kërkosh falje nga Zoti. Duaja e agjëruesit pranohet si gjatë

---

<sup>15</sup> Sujuti e transmeton këtë në "el-Xhami' es-Sagir", 4312, dhe atë e forcon Taberaniu në "el-Evsat" dhe Bejhakui në "Shuab el-Iman", nga Omer ibn Hatabi. Hajthemiu gjithashtu e ka transmetuar këtë në Mexhma ez-Zavaid, 3/143, duke komentuar (me një paralajmërim) se, "Tabaraniu e ka transmetuar këtë në "el-Evsat", por zinxhiri i tij për këtë hadith përmban Hilal ibn Abdurrahmanin, i cili njihet si transmetues i dobët". Hilal ibn Abdurrahmani gjendet në "Da'if el-Xhami' es-Sagir" të shejh Albanit, #3038. Shih gjithashtu "Et-Tergib uet-Terhib", 2/104, të Ibn Haxher el-Askalanit.

agjërimit ashtu edhe në kohën e iftarit. Për këtë arsye, Ibn Omeri, kur e prishte agjërimin thoshte: "O Allah! O Ti që posedon falje madhështore! Më fal mua!" Ekziston gjithashtu një hadith që Ebu Hurejra e transmeton si fjalë të Pejgamberit ﷺ në lidhje me vlerën e muajit Ramazan, se agjëruesit: *"Të gjithë do të jenë të falur në të (Ramazan), përveç atij që refuzon"*. Të pranishmit pyetën: "O Ebu Hurejre! Kush janë ata që refuzojnë?" Ai u përgjigj: "Ai që refuzon t'i kërkojë falje Allahut (istigfar)".

- Kërkim-falja e melekëve për agjëruesit derisa ta prishin agjërimin, gjë e cila është përmendur më lart.

Duke parë se si shkaqet për falje rriten dukshëm në Ramazan, ai që e humb këtë mundësi vërtet është privuar jashtëzakonisht shumë.

Në Sahihun e Ibn Hibanit<sup>24</sup> është transmetuar nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Pejgamberi ﷺ një herë u ngjiti në minber dhe tha: *"Amin! Amin! Amin!"* Të pranishmit pyetën: *"O i Dërguari i Allahut, u ngjite në minber dhe the: "Amin! Amin! Amin!" Përse vallë?"* Ai u përgjigj: *"Vërtet, Xhibrili erdhi tek unë dhe tha: "Kushdo që e arrin muajin e Ramazanit dhe nuk del prej tij i falur, dhe si*

*pasojë futet në Zjarr, Allahu e largoftë (nga mëshira e Tij)!, thuaj Amin!" Dhe kështu thashë: "Amin!" (Pastaj më tha) "Dhe kushdo që arrin njërin ose të dy prindërit gjallë dhe nuk i nderon dhe respekton ata, pastaj vdes në këtë gjendje dhe si pasojë futet në Zjarr, Allahu e largoftë (nga mëshira e Tij)!, thuaj Amin!", dhe kështu thashë: "Amin!" (Pastaj tha) "Dhe kushdo që, kur ti përmendesh në praninë e tij, nuk të çon lutje dhe bekime mbi ty (salavate), pastaj vdes në këtë gjendje dhe si pasojë futet në Zjarr, Allahu e largoftë (nga mëshira e Tij)!, thuaj Amin!" Dhe kështu thashë: "Amin!"*

Këtë hadith e kanë transmetuar edhe imam Ahmedi<sup>16</sup> dhe Tirmidhiu, kurse Ibn Hibani e transmeton përmes një rruge tjetër me një formulim paksa të ndryshëm: "u poshtëroftë (i atilli)!", e të cilin imam Tirmidhiu e klasifikon si hasen (të mirë). Seidi transmetohet të ketë thënë nga Katade: "Thuhej se:

---

<sup>16</sup> Shih "Musnadi i Imam Ahmedit", 2/254, "Suneni i Tirmidhiut", 2039, në kaptinën e lutjeve, nënkaptina nr. 110. Imam Ahmedi thotë se hadithi që vie nga kjo rrugë është garib (shih terminologjinë e hadithit). Mirëpo, hadithi në fakt është sahih (i saktë), dhe ka shumë dëshmi për këtë nga një numër i madh sahabësh. Hafiz el-Mundhiri u citoi këtë në "et-Tergib vet-Terhib", 2/205-207.



Kush nuk del i falur nga Ramazani, nuk do të arrijë kurrë faljen jashtë tij."

Një hadith tjetër thotë: "Nëse një personi nuk i janë falur mëkatet në Ramazan, atëherë kur do t'i falen mëkatet të këtillit, nëse nuk i janë falur në këtë muaj?! Kush tjetër do ta pranojë një person i cili është refuzuar në Natën e Kadrit? Kur do të përmirësohet ai që nuk e ka përmirësuar veten e tij në Ramazan? Kur do të shërohet ai që vuan nga dy sëmundjet: injoranca dhe shkujdesja? Çdo pemë që nuk lulëzon në sezonin e dhënies së frutave, shpejt do të pritët dhe do të hedhet në zjarr. Kush lë pas dore mbjelljen e farës gjatë sezonit të mbjelljes, nuk do të korrë asgjë në ditën e korrjes, përveçse pendim dhe dështim."

*Muaji i durimit dhe ngazëllimit morri rrugë dhe shkoi...*

*E ai që i shërbeu, u veçua për Xhenet dhe fitoi Kurse i shkujdesuri i shkretë mbeti i thyer...*

*Një si unë, ... mjerë për të sa i privuar*

*Kush lë pas dore mbjelljen e farës gjatë sezonit të mbjelljes,*

*nuk korrë gjë në ditën e korrjes, përveçse pendimit dhe keqardhjes.*

Muaji Ramazan është muaji, një e treta e parë e të cilit është mëshirë, një e treta e dytë e të cilit është falje dhe një e treta e fundit e të cilit është lirim nga Zjarri. Ky hadith është transmetuar nga Profeti ﷺ nga Selman Farisiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Atë e ka transmetuar Ibn Huzejme në Sahihun e tij<sup>17</sup>. Hadithi transmetohet gjithashtu nga Ebu Hurejra. Po ashtu atë e kanë transmetuar edhe Ibn Ebu Dunja dhe të tjerë.

Në të vërtetë, i tërë muaji i Ramazanit karakterizohet me mëshirë, falje dhe lirim (nga Zjarri). Këtë e dëshmon edhe hadithi i saktë: “Në të hapen dyert e mëshirës.”

Kurse në Tirmidhi<sup>18</sup> dhe gjetiu qëndron: “Allahu çdo natë liron njerëz nga Zjarri (gjatë Ramazanit).”

---

<sup>17</sup> Kjo është një pjesë e një hadithi të transmetuar nga Ibn Huzejme në Sahihun e tij, 3/191, 1887 në lidhje me agjërimin, në kapitullin që ka të bëjë me vlerat e muajit të Ramazanit. Ai konsiderohet i dobët për shkak të pranisë së Ali ibn Zejd ibn Xhed'anit në zinxhirin e tij. El-Bena ka thënë në "El-Fet'h er-Rabani", 9/233: "Ibn Huzejme e ka transmetuar atë në Sahihun e tij." Më pas ai vazhdon, duke thënë se është duke aluduar në zinxhirin e tij se është i shëndoshë. Ebu Shejh Ibn Hibani gjithashtu e ka transmetuar atë në "Et-Thevab".

<sup>18</sup> Kjo është një pjesë e asaj që ka transmetuar Tirmidhiu me numër 682, rreth agjërimin, në kapitullin që flet për bujarinë e Ramazanit. Është transmetuar gjithashtu nga Xhabiri (Allahu

Mirëpo, në pjesën e parë të tij dominon mëshira, e cila është enkas për të punëmirët dhe të devotshmit. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve." (Arafë, 56) Allahu i Lartësuar gjithashtu ka thënë: "... mëshira lme përfshin çdo gjë. Atë do t'ua jap atyre që ruhen nga gjynahet e japin zekatin, atyre që u besojnë shpalljeve Tona." (Arafë, 156)

Pra, në fillim të muajit, stolitë e mëshirës dhe pranimit hyjnor derdhen mbi ata që janë të devotshëm, kurse njerëzit e Ihsanit<sup>19</sup> trajtohen me mirësi dhe dashamirësi.

Sa i përket mesit të muajit, në të mbizotëron falja. Agjëruesit gjatë këtyre ditëve janë të falur, edhe nëse bëjnë disa mëkate të vogla, gjë që nuk i

---

qoftë i kënaqur me të!) në një hadith të vlerësuar si sahih nga Ibn Maxheh #1643, mbi agjërimin, në kapitullin e begative të Ramazanit, se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Vërtet, Allahu liron njerëz nga Zjarri për çdo iftar, dhe këtë e bën çdo natë të Ramazanit." Imam Ahmedi transmeton një variant tjetër në Musnedin e tij, 2/254, nga Ebu Hurejra dhe Ebu Seid Hudriu, me zinxhir të shëndoshë, se: "Vërtet, liron njerëz nga Zjarri çdo ditë dhe natë të Ramazanit, dhe çdo rob ka një dua të përgjigjur çdo ditë dhe natë të Ramazanit."

<sup>19</sup> Ihsan: Grada më e lartë e besimit, që nënkupton: ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh.



pengon që të jenë të falur, siç thotë Allahu: “Zoti yt është Falës për njerëzit, pavarësisht gjynaheve të tyre.” (Rrad, 6)

E sa i përket pjesës së fundit të muajit, në të lirohen nga Zjarri ata të cilët janë pushtuar nga barrët e mëkateve dhe të cilëve u qe bërë obligim Zjarri për shkak të mëkateve të tyre të mëdha.

Kurse në hadithin e Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmetohet nga Pejgamberi ﷺ të ketë thënë: *“Çdo natë të muajit Ramazan, në iftar, Allahu liron nga Zjarri një milion<sup>20</sup> njerëz; të gjithë janë të cilët më parë e kanë merituar të jenë banorë të Zjarrit. E kur të arrijë nata e fundit e Ramazanit, atë ditë Allahu liron aq sa ka liruar prej fillimit të muajit e deri në fund”*. E nëse është nata ose dita e xhumasë, një milion njerëz lirohen nga zjarri çdo orë, të gjithë janë të cilët më parë e kanë merituar të jenë të dënuar për shkak të veprave të tyre. Këtë e ka transmetuar Seleme ibn Shebib dhe të tjerë.

Në fakt, ajo çfarë e bën ditën e mbarimit të Ramazanit (Bajramin e Fitrit) festë për të gjithë

---

<sup>20</sup> Në arabisht është përdorur shprehja “elf elf”, e që do të thotë “një mijë mijë”, pra një mijë me tri zero prapa, e që korrespondon me numrin një milion që ne e përdorim sot.

komunitetin musliman (umetin) është se atë ditë lirohen nga Zjarri agjëruesit që kanë pasur mëkate të mëdha, rrjedhimisht mëkatarët u bashkëngjiten radhëve të të devotshmëve; ashtu sikur edhe dita e Bajramit të Kurbanit e cila konsiderohet festë e madhe për shkak se mu para saj ndodhet dita e Arafatit, ditë kjo që nuk ka ditë tjetër në dynja në të cilën lirohen më shumë njerëz nga Zjarri se në të; Prandaj, kushdo që lirohet nga Zjarri në një rën prej këtyre dy ditëve, për të është ditë feste, e kujtudo që i ka ikur lirimi nga Zjarri, atëherë për të është ditë kërcënimi.

*Nuk është festë për të dashurin kur ia mësyn  
vendfaljes...*

*për ta pritur ndonjë udhëheqës a njeri;*

*Por festë është të jesh tek Allahu fisnik...*

*i afërt tek Ai dhe në siguri.*



Njëri nga njerëzit e dijsëm për Allahun<sup>21</sup> është parë ditën e Bajramit në një lëndinë duke qarë e dënesur për veten e tij, duke recituar:

*Sa shumë pengesë më shkakton privimi nga vetmia...  
(O Zot) A nuk do të kesh mëshirë për mua, a nuk do të tregohesh Bujar!?*

*Gëzimi i Bajramit është shpërndarë anë e mbanë...  
Kurse mua mërzia vetëm se më shtohet, e nuk ikën matanë,*

*Nëse gabimeve të këqija u jam qasur...  
Arsyetim kam se atje më s'ke për t'më hasur.*

---

<sup>21</sup> Arifinë.

Për shkak se, si falja, ashtu edhe lirimi nga Zjarri, vijnë si rezultat i agjërimit të Ramazanit dhe faljes gjatë netëve të tij, Allahu i Lartësuar urdhëroi që ta madhërojmë Atë dhe ta falënderojmë me përfundimin e Ramazanit, ndaj tha: "Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë, e që ta falënderoni Atë." (Bekare, 185) Pra, falënderimi i Atij që i bekoji robërit e Vet duke ua lehtësuar agjërimin, duke i ndihmuar që të agjërojnë dhe duke i falur dhe liruar nga Zjarri - realizohet duke e përmendur Atë, duke e falënderuar Atë, dhe duke iu bindur Atij me frikë-respektin që i takon. Dhe, Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e ka shpjeguar se frikë-respekti ndaj Zotit (takvallëku) është që t'i binden Atij dhe të mos e kundërshtojnë, që të përmendet dhe të mos harrohet, dhe që të falënderohet e të mos mohohet.

Ndaj, o ju që keni mëkate të mëdha! Mësyjuani përfitimeve të mëdha në këto ditë fisnike, ngase për to s'ka zëvendësim dhe s'ka vlerë tjetër më të madhe. Ah sa njeriu gjatë tyre lirohet nga Zjarri, prej atyre që kanë gjynahe e gabime; e kush lirohet gjatë këtyre ditëve nga Zjarri, ka korrur një fitore gjithëpërfshirëse e një dhuratë sublime.





O ti që Zoti i tij e ka liruar nga Zjarri! Kujdes e të kthehesh edhe njëherë, pasi je çliruar, në robërinë e mëkateve! Zotëria yt të largon, kurse ti ia mësyn t'i afrohesh? Ai të shpëton kurse ti prapë e hedh veten në të dhe nuk shmangesh!?

*Ai që zjarrin shmangu, vërtetë veten e shpëtoj...*

*Ai që u largua nga punët që çojnë në të...*

*veten e lumturoj.*

Ndonëse mëshira u përket mirëbërësve (muhsininëve), as keqbërësit nuk duhet të dëshpërohen nga ajo; ndonëse falja është e përcaktuar për ata që ruhen (muttekinët), as zullumqari nuk është i privuar nga ajo.



*Nëse faljen Tënde s'do ta shpresonte mëkatari...*

*Kush tjetër i përfshin mëkatarët përveç se Bujari!?*

\*\*\*

*Nëse vetëm i miri shpreson në Ty...*

*Kë tjetër ta lutë e n'të të shpresojë*

*ai që në mëkate u mbyl!?*

\*\*\*

*Si të mos shpresojmë faljen nga Zoti ynë...*

*E si të mos lakmojmë në butësinë e Tij,*

*Kur në sahihejn<sup>22</sup> është transmetuar*

*se Ai është më i mëshirshëm për robin se e  
ëma e tij!*

---

<sup>22</sup> Në dy librat e saktë të hadithit: Buhariun dhe Muslimin.

“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet.” (Zumer, 53) Ndaj, o ti mëkatar - e të gjithë jemi të këtillë - mos e humb shpresën nga mëshira e Allahut për shkak të punëve tua të këqija, ngase, sa ka sikur ti që gjatë këtyre ditëve lirohen nga Zjarri! Ndreqe mendimin për Zotin tënd dhe pendohu tek Ai, ngase tek Allahu nuk shkatërrohet askush, pos atij që është i shkatërruar (me vetëdëshirë).

*Kur gjynahet të të kenë plagosur, shëroji ato...*

*Me ngritje duarsh natën, kur nata është e errët,*

*E mos u dëshpëro nga mëshira e Allahut se...*

*Ky dëshpërim i yti, është më i madh se vetë gjynahu,*

*Mëshira e Tij për të mirët është fisnikërim...*

*Kurse për mëkatarët, mëshira e Tij është nderim.*

Ai i cili shpreson që të lirohet nga Zjarri gjatë muajit të Ramazanit, duhet të veprojë shkaqet që obligojnë lirimin nga Zjarri, e të cilat janë të lehtësuara gjatë këtij muaji. Ebu Kilabe lironte në

fund të muajit një robëreshë të pashme e të bukur<sup>23</sup>, me lirimin e të cilës shpresonte që Allahu ta lirojë atë nga Zjarri. Në hadithin e Selman Farisiut (Allahu qoftë i kënaqur me të!) që mbërrin tek Pejgamberi ﷺ i cili është cituar në Sahihun e Ibn Huzejmes<sup>24</sup>, thuhet: *"Kush i jep ushqim një agjëruesi në këtë muaj, për të do të jetë lirim nga Zjarri; e kush ia lehtëson një robi (skllavi) në këtë muaj, për të do të jetë lirim nga Zjarri."*

Po aty thuhet: *"Andaj, mundohuni t'i veproni më shumë katër gjëra në të: dy prej të cilave e kënaqni Zotin tuaj me to, e dy të tjera pa të cilat nuk bën. Sa u përket atyre dyjave me të cilat e kënaqni Zotin tuaj, ato janë:*

1. Dëshmia se s'ka zot të denjë për adhurim pos Allahut (La ilahe ilAllah) dhe
2. Kërkim-falja (istigrafi)<sup>25</sup>.

Kurse dy të tjerat pa të cilat nuk bën janë:

---

<sup>23</sup> Ndërsa në disa kopje ka një dallim të vogël në shkronja në origjinal, e që nënkupton "të edukuar".

<sup>24</sup> 3/192, nr. 1887, rreth agjërimit; është përmendur më herët rruga e transmetimit.

<sup>25</sup> Kurse në Sahihun e Ibn Huzejmes është thënë: "t'i kërkoni falje Atij."

1. Ti kërkoni Allahut Xhenetin dhe
2. Ti kërkoni mbrojtjen nga Zjarri.”

Andaj, këto katër veçori të cilat janë përmendur në këtë hadith, që të gjitha janë shkaqet që duhet vepruar për t'u liruar nga Zjarri dhe për falje. Sa i përket fjalës së njëshmërisë (teuhidit)<sup>26</sup>, ajo i shkatërron mëkatet dhe i fshin përgjithmonë; nuk lë pas vetes mëkat dhe nuk i paraprin asaj ndonjë vepër. Madje, ajo është e barasvlershme me lirimin e një robi, e rrjedhimisht obligon lirimin nga Zjarri. Kush e thotë atë katër herë: në agim dhe në mbrëmje, Allahu do ta lirojë nga Zjarri, sakaq ai që i thotë ato sinjerisht nga zemra e tij, Allahu ia bën haram atë Zjarrit.

E sa i përket fjalës së istigfarit (kërkimfaljes), ajo është prej shkaqeve më të mëdha të faljes, ngase ajo është lutje (Allahut) për falje, kurse lutja e agjëruesit është e pranuar gjatë kohës kur është agjërueshëm dhe gjatë kohës kur bën iftar. Është cekur më herët hadithi i Ebu Hurejras që ia delegon Pejgamberit ﷺ se: *"Të gjithë do të jenë të falur në të*

---

<sup>26</sup> Dëshmisë "La ilahe ilAllah" e cila dëshmon se Allahu është Një dhe i Vetmi. Ar. Teuhid.

- pra në Ramazan – përveç atij që refuzon". Të pranishmit pyetën: "O Ebu Hurejre! Kush janë ata që refuzojnë?" Ai u përgjigj: "Ai që refuzon t'i kërkojë falje Allahut (istigfar)". Kurse Haseni ka thënë: "Shtojeni istigfarin ngase ju nuk mund ta dini se kur do të zbresë mëshira." Lukmani i pati thënë të birit: "O biri im! Mësoje gjuhën të bëjë istigfar, ngase Allahu ka caktuar disa kohë në të cilat nuk e refuzon lutësin." Po ashtu, Allahu ka bashkuar midis teuhidit dhe istigfarit në Fjalën e Tij: "Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut! Kërko falje për gjynahun tënd..." (Muhamed, 19) Ndërsa në disa thënie të selefit është përmendur se Iblisi paskësh thënë: "I kam shkatërruar njerëzit përmes mëkateve, kurse ata më shkatërruan mua me "La ilahe ilAllah" dhe me istigfar." Po ashtu, istigfari është vula e çdo vepre të mirë, ngase me të mbarohet namazi, haxhi dhe namazi i natës, e me të po ashtu mbarohen ndejat e ndryshme dhe, kështu, nëse ka qenë përmendje e Allahut (ose përhapje e diturisë) e mbaron ndejën me të, e nëse ka qenë kotësi, ajo do të bëhet shpagim për të. Andaj, në të njëjtën mënyrë, edhe agjërimi i Ramazanit duhet të mbyllet me istigfar (kërkimfalje).

Omer ibn Abdulazizi u pati shkruar njëherë qyteteve që i kishte nën udhëheqje që muajin e Ramazanit ta mbarojnë me istigfar dhe lëmoshë, sadakatul fitrin, ngase sadakatul fitri është pastrim për agjëruesin nga fjalët e këqija dhe punët e kota, kurse istigfari arnon atë që është shqyer nga agjërimi për shkak të fjalëve të këqija dhe punëve të kota. Pra, me të drejtë, disa dijetarë të moçëm kanë thënë: “Sadakatul fitri është për agjëruesin sikurse dy sexhdet e harresës (sehvi sexhdet) për namazin.” Ndërsa në shkrimin e tij Omer ibn Abdulazizi kishte thënë: “Thuani atë që e ka thënë babai juaj Ademi: “O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.” (Araf, 23) dhe thuani siç ka thënë Nuhu (paqja qoftë mbi të!): “Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të jem nga të humburit.” (Hud, 47) dhe thuani siç ka thënë Ibrahim (paqja qoftë mbi të!): “... dhe i Cili, shpresoj se do të m'i falë gabimet e mia në Ditën e Gjykimit!” (Shuara, 82) dhe thuani siç ka thënë Musai (paqja qoftë mbi të!): “O Zoti im! Njëmend, Unë i kam bërë keq vetes, andaj më fal!” (Kasas, 16) dhe thuani siç ka thënë Dhun Nuni (paqja qoftë mbi të!): “S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!” (Enbija, 87)

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë: "Përgojimi (gibeti) e shqyen agjërimitin, kurse istigfari e arnon atë. Andaj, kushdo që ka mundësi të vijë me agjërimit të arnuar, le ta bëjë." Kurse Ibn Munkediri ka thënë: "Kuptimi i kësaj është se agjërimiti është mburojë nga Zjarri për atë që nuk e ka shqyer<sup>27</sup>, ndërsa fjala e keqe e shqyen këtë mburojë, kurse istigfari e arnon atë që është shqyer prej saj. Andaj, agjërimiti ynë ka nevojë për istigfar të dobishëm dhe vepra të mira që do të jenë ndërmjetësuese për të. Sa herë e shqyejmë agjërimitin tonë me shigjetat e fjalëve, pastaj e arnojmë dhe arnuesi e vëren gjerësinë e shqyerjes.

---

<sup>27</sup> Hadithin e shënon Nesaiu 4/167,168, rreth agjërimitit, kapitulli që flet për vlerën e agjërimitit, nga Ebu Ubejde ibn Xherrahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i cili ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin ﷺ duke thënë: "Agjërimiti është mburojë, përderisa të mos e ketë shqyer atë." E ka transmetuar edhe Darimiu, 2/15, dhe ka thënë: "pëderisa të mos e ketë shqyer," domethënë përmes përgojimit; hadithi është i mirë (hasen).



Sa të shqyerat i rregullojmë me penjtë e veprave të mira pastaj i këpusim me shpatat e mprehta të veprave të këqija. Disa nga të parët e devotshëm, kur mbaronin një namaz, kërkonin falje pas tij sikur një mëkatar siç kërkon falje pas gjynahut që e bën. Nëse kjo ka qenë gjendja e të mirëve me adhurimet e tyre, vallë si është gjendja e keqbërëse sikurse ne me adhurimet tona?! Mëshiroje atë që veprat e mira i ka të këqija, kurse adhurimet të gjitha i ka pakujdesi!

*I kërkoj falje Allahut për agjërimin tim...*

*Gjatë gjithë kohës,... e edhe për namazin tim,*

*Agjërimi ynë është përplot shqyerje...*

*E namazi, ah çfarë namazi,*

*I zgjuar në errësi (për namaz) por...*

*Më i mirë se ky zgjim i imi do të ishte gjumi.*

I përfaqësuar me këtë është edhe mësimi që Pejgamberi ﷺ ia dha Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) natën e Kadrit që të kërkojë faljen (el-afua); ngase besimtari gjatë Ramazanit përpiqet me agjërim dhe namaz nate, andaj, me t'iu afruar fundit, nëse e qëllon natën e Kadrit, nuk e lut më Allahun për diçka tjetër pos për falje, si dikush që nuk ia ka

dhënë hakun dhe ka lënë mangu diçka. Ja ku e kemi atje Siletu ibn Eshimin<sup>28</sup> i cili e gjallëronte natën (me ibadet), pastaj në kohën e syfyrit lutej: "O Allah, kërkoj nga Ti që të më shpëtosh nga Zjarri, por ja që, një si unë nuk ka guxim të ta kërkojë Xhennetin!" Kurse Mutarrifi thoshte gjatë lutjes së tij: "O Allah, ji i kënaqur me ne, e nëse nuk je i kënaqur me ne, atëherë na fal." Jahja ibn Muadhi thoshte: "Ai që nuk e ka synim kryesor të tijin faljen e Allahut, nuk është njohës i Allahut."

*Nëse unë s'jam i denjë që të jem i afërt (me Ty)...*

*Atëherë Ti je i denjë që të ma falësh mëkatin!*

Istigfari më i dobishëm është ai i cili shoqërohet me pendim (teube), një gjë e tillë zgjidh nyjën e këmbënguljes<sup>29</sup>. Andaj, ai që kërkon falje me gjuhën e tij kurse zemra e tij është e lidhur për gjynahun, dhe është i vendosur që pas mbarimit të muajit (të

---

<sup>28</sup> Siletu ibn Eshimi ishte dijetar, transmetues i hadithit dhe pasardhës i sahabëve (tabiin); ishte edhe shehid në rrugën e Allahut. Ai ishte i martuar me dijetaren e drejtë nga radhët e tabiinëve dhe transmetuesen e hadithit Muadhe bint Abdullah el-Adevijeh. Imam Dhehebiu e quan atë "asketi, adhuresi i zjarrtë, modeli, Ebu Sahba' el 'Adevi el-Basri, bashkëshorti i dijetares femër Muadhe el-Adevije.

<sup>29</sup> Këmbënguljes në mëkat.

Ramazanit) t'i kthehet prapë mëkatit, agjërimi i tij është i refuzuar, kurse porta e pranimit për të është e bllokuar.

Kabi (Allahu goftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Kush e agjëron Ramazanin dhe i flet vetvetes se pas mbarimit të agjërimit, pas Ramazanit, s'do t'i bëjë më mëkat Allahut, do të hyjë në Xhennet pa u marrë në pyetje dhe pa dhënë llogari. Ndërsa kush e agjëron Ramazanin dhe i flet vetvetes se pas mbarimit të agjërimit, pas Ramazanit, do t'i bëjë mëkat Allahut, agjërimi i tij është i refuzuar. Këtë e ka transmetuar Seleme ibn Shebibi<sup>30</sup>.

*Po të mos ishte devotshmëria, pastaj intelekti  
dhe më pas frika nga përçmimi...*

*Në kohën e përmallimit,  
do të refuzoja çdo lloj qortimi*

*Është shkruar çfarë është shkruar, dhe ka kaluar...*

*Nuk u shihet më kthimi netëve të humbura.*

---

<sup>30</sup> Ai është Seleme ibn Shebib Nejsaburiu, dhe biografia e tij është përmendur më herët.

Në Sunenin e Ebu Davudit<sup>31</sup> dhe në libra të tjerë transmetohet nga Ebu Bekrete (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *"Mos të thotë dikush: "E agjërova Ramazanin të tërin", e as: "fala namazin e natës tërë Ramazanin."* Ebu Bekrete thotë: "Nuk e di a ishte kjo për shkak se e urrente të shfajësonte (pastronte) dikush vetveten, apo për shkak se nuk shpëtojmë dot prej shkujdesjes."

Ku është ai që kur agjëron, e ruan agjërimin, e kur ngrihet për namaz nate, është i qëndrueshëm në namaz? Njerëz të tillë e kanë përsosur Islamin e tyre dhe janë larguar nga kjo botë në paqe; kurse tani, s'kanë mbetur të tjerë pos të atillë që, nëse agjërojnë, mburren, e nëse qëndrojnë për t'u falur natën, janë të dashuruar me veten e tyre. Eh sa dallim ka midis atij që ka mendje të qetë dhe midis të brengosurit, midis atij që ka (vepra) dhe atij që s'ka, si dhe midis atij që i fsheh veprat e mira dhe atij që i shpërfaq ato! E kur jemi te kërkimi i Xhennetit dhe kërkim-mbrojtjes nga Zjarri, kjo është prej

---

<sup>31</sup> E shënon Ebu Davudi me numër 2415, agjërimi, kapitulli në lidhje me atë që thotë: "E kam agjëruar Ramazanin të tërin;" si dhe Nesaiu 4/130, agjërimi, kapitulli "lejimi që dikush ta quajë muajin e Ramazanit Ramazan;" mirëpo në këtë transmetim ndodhet edhe "an-ane" (terminologji që aludon në kapërcimin e transmetuesve) e Hasen el-Basriut.

lutjeve më të rëndësishme; saqë edhe Pejgamberi ﷺ pati thënë: *"Edhe ne rreth këtyre (lutjeve) sillemi."*<sup>32</sup>

Kësisoj, agjëruesi shpresohet që lutja e tij të pranohet, andaj kërkohet nga ai që të lutet vetëm për çështjet më të rëndësishme. Ebu Muslimi<sup>33</sup> ka thënë: "Sa herë kam dashur të lutem për diçka, e kam orientuar lutjen nga kërkimi i mbrojtjes nga Zjarri,

---

<sup>32</sup> Pjesë e hadithit të transmetuar nga Ebu Davudi në kapitullin mbi namazin ku thotë: "I Dërguari i Allahut i tha një njeriu: *"Çfarë thua në namaz (kur lutesh)?"* Ai (burri) tha: "Unë bëj teshehud, pastaj them: "O Allah, kërkoj të ma japësh Xhenetin dhe kërkoj strehim tek Ti nga zjarri i Xhehenemit," por unë nuk di t'i thur lutjet sikurse ti dhe Muadhi"; I Dërguari i Allahut ﷺ i tha: *"Edhe unë e Muadhi rreth këtyre (lutjeve) sillemi."* Ky transmetim përcillet edhe në Musnedin e Imam Ahmed ibn Hanbelit, 3/474, si dhe tek Ibën Maxhe, hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejra, kapitulli i faljes së namazit (910), konkretisht në pjesën se çfarë të thuhet në teshehud dhe si bëhet salavati për Pejgamberin ﷺ. Ndërkaq Busajri në "Ez-Zevaid" thotë: "Zinxhiri i transmetimit të këtij hadithi është i shëndoshë dhe njerëzit e tij (në zinxhir) janë të besueshëm."

<sup>33</sup> Ebu Muslim El-Havalaniu, Abdullah ibn Thuvabi, është tabiin (pasardhës i sahabëve), jurist, adhurues i devotshëm dhe asket. Ndonëse ai e pranoi Islamin para vdekjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ, megjithatë nuk arriti ta takojë atë. Ai ndërroi jetë në Damask dhe u varros në Darije në vitin 62 Hixhri. Një biografi e detajuar rreth tij mund të gjendet në librin "Historia e Damaskut", fq. 484 -525, botuar nga "Mexhma el-Lugatë el-arabijeh", në Damask.

pastaj lexoi: "Nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe banorët e Xhenetit; banorët e Xhenetit do të jenë të fituarit." (Hashr, 20)

Në hadith është thënë: "[Jini tërë kohën në kërkim të së mirës dhe]<sup>34</sup> paraqituni para puhive të mëshirës së Zotit tuaj. Allahu ka pui të mëshirës me të cilat e godet kë dëshiron prej robërve të Tij, - [luteni Allahun që t'jua mbulojë të metat dhe t'ju qetësojë kur t'ju ketë kapluar trishtimi]<sup>35</sup> - kë e godasin ato, e kaplon lumturia pas së cilës nuk ka më fatkeqësi. E, ndër më të mëdhatë nga këto pui është kur robi e qëllon kohën përgjigjes së lutjes ndërkohë që kërkon Xhenetin dhe shpëtimin nga Zjarri, dhe kështu i pranohet lutja dhe fiton lumturinë e përjetshme. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet)" (Ali Imran, 185) dhe ka thënë: "Ata që do të jenë të mjerë, do të hyjnë në zjarr, ku do t'i presin

<sup>34</sup> Pjesa në kllapa është plotësim i hadithit nga një kopje tjetër e librit, sakaq hadithin e ka transmetuar Ibn Ebu Dunja në librin "El-feraxh bade esh-Shidde," nr. 27, nga Ebu Hurejra. Po ashtu, e ka transmetuar Bejhakui në librin "Shuabul iman", gjithashtu nga Ebu Hurejra. E hadithin e kanë transmetuar edhe Hakimi dhe Tirmidhiu, si dhe Ebu Nuajmi në "el-Hiljeh", nga Enesi; hadithi është i dobët (daif).

<sup>35</sup> Njëjtë me fusnotën e mësipërme.

veç ofshamat e vajtimet.” (Hud, 106) e deri te Fjala e Tij: "Kurse fatlumët, do të hyjnë në Xhenet." (Hud, 108)

*S'është fatlum ai që dynjaja e ka lumturu...*

*Por i lumtur është ai që nga Zjarri ka shpëtuar!*

O robërit e Allahut! Vërtet, muaji i Ramazanit ka vendosur të largohet dhe nuk ka mbetur prej tij veçse pak. Pra, kush prej jush e ka shfrytëzuar mirë, le ta përfundojë po në atë mënyrë, e kush ka mbetur mbrapa, le ta përfundojë atë në mënyrën më të mirë, sepse shpërblimi i veprave përcaktohet sipas përfundimit të tyre. Pra, përfitoni prej asaj pak çfarë ka mbetur prej ditëve dhe netëve të tij dhe lini trashëgim vepra të mira që do të dëshmojnë për ju para Mbretit të Gjithëdijshtëm, dhe përshëndetuni me të në momentin e ikjes së tij me përshëndetjet më të pastra dhe me selam.



*Selam nga i Gjithëmëshirshmi në çdo kohë...*

*Për muajin dhe kohën më të mirë që shkoi,*

*Selam për muajin e agjërimit, se vërtet...*

*Ai është paqe e shkuar paqes, nga i  
Gjithmëshirshmi,*

*Edhe nëse ditët tua të çmuara po shkojnë...*

*Mërzia për ty nga zemra ime nuk kalon.*

Vërtet, ditët e tij me gjërat e mira që i ke punuar kaluan, ndërsa mëkatet dhe shanset e humbura në ditët janë shkruar kundër teje, pastaj pasi e arritët fundin si të zellshëm, e ndërpretë atë; A mendon se ky qortim të përket edhe ty apo s'ke dëgjuar!?





*Ato ditë tona që i humbëm,  
vallë a kompensohen disi...*

*E pamundur! Kohërat nuk rikthehen assesi!*

\*\*\*

*Atë Ditë në të cilën shitja dhe blerja bëhet me  
shpirtra,  
Atë Ditë kur vëllai refuzon të japë një dërhëm të  
vetëm për dorëzani.*

\*\*\*

*Zemrat e të devotshmëve në këtë muaj janë të  
gëzuara,  
e nga dhimbja e ndarjes ndihen të lënduara.  
Ndoshta ju ka pushtuar ndarja nga i dashuri, por  
çfarë të bësh?...*

*O do të durosh distancën, o do në ankth do të  
biesh?*

\*\*\*

*Nëse ju qani për largimin e tyre, teksa janë  
fqinjët tuaj...*

*Vallë, kur të të japin lamtumirën, si do të jetë  
gjendja juaj?*



Si nuk i rrjedhin dot lotët besimtarit për ndarjen nga ai, kurse nuk e di ai nëse i kanë mbetur vite që të kthehet edhe njëherë në të (Ramazan)?

*Kujtova ditë dhe netë që tashmë kanë kaluar...*

*E lotët me kujtimin e tyre zemrën ma përvëluan*

\*\*\*

*Vallë a do të ketë kthim edhe njëherë...*

*A do të kem edhe një shans të kthehem në kohën e dashurisë si atëherë!?*

\*\*\*

*Vallë, pasi i dashuri mua ma kthej shpinën,*

*Ne a do ta mbajmë lidhjen?...*

*Hënat që perënduan, a thua vallë a edhe njëherë do të lindin?*



Ku është djegia e të përkushtuarve përgjatë ditës? Ku është brenga e falësve të namazit të natës në errësirën e saj?

*Dëgjoji rënkimet e të përmalluarve...*

*Nëse u bën ballë dot t'i dëgjosh,*

*I dashuri ia mbathi kurse lotët e mi...*

*Rrëke u lëshuan me furi,*

*Po të ngarkohej bjeshka memece...*

*Me ndarje nga miku, nuk do t'ia dilte!*

Nëse kështu qenka mërzia e atyre që kanë fituar nga ai, si do të jetë gjendja e atyre që kanë humbur ditët dhe netët e tij? Çfarë i bën dobi të qarët atij që ka qenë i shkujdesur në të, përkundrazi, fatkeqësia e tij është e madhe e pikëllimi i zmadhuar?! I mjeri, ka qenë këshilluar, por se deshi këshillën! Sa herë u thirr për një kompromis, por thirrjes nuk iu përgjigj?! Sa shumë pa njerëz të përkushtuar në këtë rrugë, teksa ai në largësi qëndronte?!

Sa grupet e bredhësve kalonin pranë tij, kurse ai qëndronte i ulur! Derisa, kur koha iu ngushtua e fatkeqësia e goditi, ndjeu keqardhje për shkujdesjen e tij në kohën kur keqardhja nuk sjell ndonjë dobi, madje kërkoi që ta plotësojë mangësinë në kohën kur tashmë nuk ekzistonte.

*Vallë e ke braktisur atë që e ke dashur, në kohën kur e ke pasur fqinj...*

*Pastaj e kërkon atë në kohën kur vendi i vizitës është larguar?!*

*Dhe qan nga përmallimi pas largimit të tij...*

*Dhe bredh nëpër shtëpi duke pyetur se ku shkuan?!*

*Braktise kërkimin e tyre teksa i kishe afër...*

*Duke shpresuar se toka do të të sillte lajmet e tyre, Andaj, vetveten fajësoje e mos i fajëso kafshët e shaluara...*

*Vdis nga pikëllimi ngase për ty s'ka arsytim!*

O muaj i Ramazanit, trego pak dhembshuri, ngase lotët e të dashuruarve në ty kanë shpërthyer, e zemrat e tyre nga dhimbja e ndarjes po çahen. Ndoshta një ndalje për t'u dhënë lamtumirën do të ndihmonte në shuarjen e zjarrit të mallit që është ndezur! Ndoshta një moment pendimi dhe ndaljeje do të ndreqte gjithçka që u dëmtua në agjërimin tonë! Ndoshta edhe një që qe shkëputur nga karvani i të pranuarve do të bashkëngjitej! Ndoshta [edhe një rob i barrëve të mëkateve do të çlirohej, e ndoshta] edhe dikush që i qe bërë obligim Zjarri do të lirohej! [E ndoshta mëkatarit do t'i lehtësohej të arrinte mëshirën e Zotit].

*“Ndoshta e ndoshta” ka vlerë vetëm para çastit të ndarjes...*

*Ashtu që të ngrihesh në çdo mirësi që shpreson ta arrish,*

*(Vetëm atëherë) i dobëti ngushëllohet e i penduari pranohet...*

*Mëkatarit lirohet dhe fatkeqit lumturohet!*

